



RR. MYRTEZIM KELLIÇI
TIRANË, 1001, SHQIPËRI
WWW.FSHB.BASKETBALL
INFO@FSHB.BASKETBALL
f d i g o

KOMITETI DREJTUES

Nr./08 Prot.

Tiranë, 26 Dhjetor 2025

Vendim Nr. 5 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 23 dhjetor 2025, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve, znj. Migena Plasa, z. Dritan Mema, z. Blendi Dibra, si dhe z. Klevis Kaso duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Organizimi i Asamblesë së Përgjithshme Vjetore;
2. Raport i Aktiviteteve Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Vitin Kalendarik 2025;
3. Raport Financiar i vitit kalendarik 2025;
4. Fillimi i kampionateve kombëtare për vitin kalendarik 2026;
5. Të ndryshme

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës, duke trajtuar problematikat për secilën pikë të tij.

Për sa më sipër, KD-ja vendosi:

1. Miratimi i rendit të ditës për organizimin e Asamblesë së Përgjithshme, si dhe lista e vlerësimeve për vitin 2025 dhe mirënjohjet për aktivitetin ndër vite për ish-lojtarë, trajnerë dhe kontribues.
2. Miratimi i raportit mbi aktivitetet kombëtare të realizuara gjatë vitit kalendarik 2025, përfshirë edicionin e përfunduar 2024–2025, si dhe veprimtarinë e pjesës së parë të edicionit 2025–2026.
3. Miratimi i raporteve financiare për vitin kalendarik 2025.
4. Udhëzimi i administratës për përgatitjen e organizimeve kombëtare në vijim të edicionit 2025–2026, duke siguruar vazhdimësinë e kampionateve kombëtare, organizimin e Kupës së Shqipërisë për Meshkuj dhe Femra, si dhe përgatitjet për ekipet kombëtare të moshave U20, U18 dhe U16, djem dhe vajza, për vitin 2026. Në veçanti, organizimi i ndeshjes së ekipit kombëtar të meshkujve (të rritur) më 3



mars në Shkodër, si dhe ndeshja e fundit e raundit të parë të para-eliminatoreve të EuroBasket 2029, më 2 korrik 2026.

5. Te ndryshme

5.1 Komiteti Drejtues pasi shqyrtoi problematikat e hasura në kampionatet kombëtare lidhur me cënimin e përsëritur të zyrtarëve të ndeshjes nga pjeshtarë të ekipeve pjesëmarrëse, me qëllim parandalimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë, vendosi ashpërsimin e sanksioneve financiare si më poshtë:

Neni 14 Dënimet për sjelljet jospportive të lojtarëve, trajnerëve, personave të tjerë që qëndrojnë në stol apo personave drejtues të shoqatës.

- 14.1 Gabim teknik i lojtarit: 8'000 lekë **(Ishte 4'000 lekë)*
- 14.2 Gabim përjashtimi i lojtarit: 20'000 lekë **(Ishte 10'000 lekë)*
- 14.3 Gabim teknik i trajnerit ose stolit: 20'000 lekë **(Ishte 10'000 lekë për trajnerin dhe 4'000 lekë për stolin)*
- 14.4 Gabim përjashtimi i trajnerit ose stolit: 30'000 lekë **(Ishte 15'000 lekë)*
- ***Hiqet shënimi:** Gabimet teknike të dhëna ndaj personave që qëndrojnë në stol i ngarkohen trajnerit, masa e dënimit është 4'000 lekë.
- ***Shtohet shënim:** Në rast se një lojtar ose trajner dënohet me gabim përjashtimi, atëherë krahas sanksionit financiar, lojtari ose trajneri **nuk** do të ketë të drejtë pjesëmarrjeje në ndeshjen pasuese të kampionatit. Gjithashtu, në rast se një lojtar ose trajner dënohet me gabim teknik për herë të dytë brenda të njëjtës fazë të kampionatit kombëtar (Faza I-rë, Faza II-të, Faza Play-Off ose Final Four), atëherë, krahas sanksioneve financiare, lojtari ose trajneri **nuk** do të ketë të drejtë pjesëmarrjeje në ndeshjen pasuese të kampionatit kombëtar.

Ekipe që pretendojnë pasaktësi në dhënien e gabimeve teknike ose në vendimet për përjashtim të lojtarëve apo trajnerëve nga gjyqtarët gjatë zhvillimit të ndeshjeve, kanë të drejtë të paraqesin ankimim pranë Komisionit të Gjyqtarëve brenda afatit prej 24 (njëzet e katër) orësh nga përfundimi i ndeshjes. Ankimimi duhet të shoqërohet detyrimisht me:

- një relacion shpjegues të rastit;
- pamje filmike përkatëse;
- mandatin e pagesës së tarifës së ankimit në vlerën 5.000 (pesë mijë) lekë.
- Ankimet që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni ose që paraqiten jashtë afatit nuk merren në shqyrtim.
- Komisioni i Gjyqtarëve shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda afatit prej 72 (shtatëdhjetë e dy) orësh nga momenti i depozitimit të plotë të dokumentacionit.
- Komunikimi dhe depozitimi i ankimeve bëhet vetëm përmes kanaleve zyrtare të Federatës Shqiptare të Basketbollit (adresat zyrtare elektronike ose pranë zyrave të FSHB-së).



5.2 Komiteti Drejtues udhëzon Komisionin e Gjyimit që të shqyrtojë rastet e ankimimeve të paraqitura nga ekipet pjesëmarrëse në kampionatet kombëtare, për pretendime që lidhen me pasaktësi në vlerësimin e gabimeve teknike ose në vendimet për përjashtim të dhëna nga gjyqtarët gjatë ndeshjeve, duke i dhënë të drejtë Komisionit të Gjyimit që, në rast pranimi të ankimimit, të shfuqizojë sanksionin financiar si dhe dënimin për heqjen e së drejtës së pjesëmarrjes në ndeshjen pasuese, me kusht që ankimimi të jetë paraqitur të paktën 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) orë përpara zhvillimit të ndeshjes së radhës.

Avni Ponari
President



Ersi Oruçi
Sekretar i Përgjithshëm

Ersi Oruçi

